



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/217

Datë: 17.06.2019

Procesverbal

i mbledhjes së V (e pestë) për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -IV- të KPF-së.
2. Shqyrtimi i Raportit të Lëndëve për pensione dhe paga jubilarë.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Planit të integritetit të Komunës së Malishevës për vitin 2018-2020.
4. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë së Bujqësisë për mbjelljet pranverore për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i Raportit të Punës së DKRS, për periudhën Janar-Maj 2019.
6. Debat për hartat zonale.
7. Shqyrtimi i kërkesave .
8. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë:29.05.2019, filloj në ora 10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i Osbe, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e pestë, sot kemi të pranishëm një grup të artistëve që kanë parashtruar një kërkesë për një teatër mbledhjen e kaluar e kemi trajtuar kërkesën por qëndrimi ynë ka qenë t'i takojmë sot e ata kanë ardhur nëse munden te na presin deri sa t'i përfundojmë pikat e mbledhjes, pastaj i thërrasim ata në takim. Kështu që para përfundimit të mbledhjes ju thërras edhe diskutojmë lidhur me kërkesën tuaj.

Alban Krasniqi: Kjo çështje mund të mos jetë në rend të ditës, por që mund ta diskutojmë.

Hashim Vrenezi: Ketë kërkesë e trajtojmë në fund të mbledhjes.

Përfaqësuesja e grupit: Unë jam regjisorë në Suharekë në teatër por që kemi shpreh interesim edhe në Malishevë. Njëherë për fillim na duhen tre regjisorë e vitin tjetër mund të jetë edhe trupa e aktorëve.

Rahim Morina: Për rendin e ditës e keni diçka?

Alban Krasniqi: Deshta të dijë mbledhjen e fundit në Kuvend a keni vendos diçka lidhur me formimin e Këshillit Organizativ?

Rahim Morina: Po në mbledhjen e kaluar e kemi formuar Këshillin Organizativ ashtu qysh ka qenë edhe viteve tjera, shefat e grupeve.

Rahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -IV- të KPF-së.

Rahim Morina: Kush jeni për miratim të këtij procesverbali? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i Raportit të Lëndëve për pensione dhe paga jubilarë.

Rahim Morina: Ne kemi pas marr vendim vitin e kaluar t'i paguajmë kategorinë e pensionistëve, Mapl e ka konfirmuar ligjshmërinë e vendimit, drejtorja e financave kanë thënë se nuk mund të zbatohet ai vendim. Këta mësimdhënës pas pensionimit po bëjnë padi, tani përmes një shkresë të

avokatit të Komunës janë me emra dhe mbiemra kush janë si dhe shumat. Kryetari dhe drejtorja nuk kanë planifikuar se nga cilat projekte duhet të merren ato mjetë që të barten për këtë kategori.

Alban Krasniqi: Ky raport që ka sjellë Avokati komunal atij si ka takuar mu marrë me të, sepse ai si paguan. Koston e tyre është dashtë ta kemi me tabela raporti duhet të jetë narrativ dhe tabelar, duhet të dihet sa ka humbur Komuna nga një papërgjegjësi sepse ky 8% s'mund të jetë i njëjtë nga mos zbatimi i vendimit të Kuvendit. Ne e dimë se po kjo Ministri e financave me ato departamente kur lëndët shkojnë në gjykatë mjetet i marrin nga investimet kapitale. Nëse drejtorja ka thënë se nuk bën të zbatohet është dashtë me kërkuar me shkrim. Kryetari i ka sjellë pensionistet në një gjendje që për një të drejtë të tyre të sillen si lypsar. Në rast se duhet bërë kompensimin sa raste janë të hapura dhe cilat rrugë duhet mu ndjekë mi hjekë prej mallrave dhe shërbimeve drejtorja është dashtë me na orientuar.

Hashim Vrenezi: Ky raport ska informata me shqetësuese është pse qeverisja komunale nuk din me bere planifikim e në fund qysh kanë drejt mjetet mu marrë prej projekteve kapitale. Kjo listë është diskriminuese, çka meju bërë tash atyre që ndoshta skano pas pare as me parashtruar padi e s'kanë parashtrua ndoshta hiq padi. Kjo kategori duhet të trajtohen të gjithë barabartë.

Muharrem Morina: Unë në konsultim me Avokatin e Komunës me ka thënë se po vijnë padi vazhdimisht dhe shpenzimet po rriten, ose edhe në ankesa të ndryshme shpenzimet prapë rriten.

Rrahim Morina: Kemi kërkuar nga Kryetari sa është numri i pensionistëve, sa mjete duhet të hiqen, propozoj kjo pikë të debatohet por te kemi material shtesë.

Alban Krasniqi: Njerëzit përgjegjës duhet me zbatu e nëse ashtu ne në kuvend e konfirmojmë dështimin atëherë buxheti dëmtohet me vetëdije. Të sillet raport me listën e punëtorëve prej viti 2019 deri me 2019, sa raste janë në Gjykatë çka kërkohet, cila është shuma e kërkuar sa janë pagu deri tash për sa seanca gjyqësore ka pagu Komuna për secilin rast dhe sa është përqindja tyre dhe sa pritet me dal në pension në këtë vit.

Duhet ta kemi kërkesë që kanë kontaktuar më Mef-in departamentin përkatës në formë të shkruar se prej cilës kategori mund t'i ndajnë mjetet para se të shkojnë lendet në gjykatë dhe me na tregu sa ka qenë demi ne vitin 2018.

Hashim Vrenezi: Të sillet informacion pse sa zbatu vendimi nëse Mef ka thënë jo, me na tregu ku kanë shkruar ato mjete.

Raimonda Krasniqi: Duhet të dimë sa ka qenë periudha e punës e një pensionisti pse tani nuk na kanë sjellë, pse sa zgjidh ky problem para se me shkruar në gjykatë.

Alban Krasniqi: Të sillet lista pra prej 2015 deri tani, kompensimi për secilin rast, pse sa zbatu vendimi ku kanë shkruar ato mjete te parapara, aka pas komunikim me Mef-in, nëse po te na njoftojnë dhe cili ka qenë qëndrimi i tyre.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim për kuvend të kësaj pikë? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Planit të integritetit të Komunës së Malishevës për vitin 2018-2020.

Muharrem Morina: Edhe vitin e kaluar ju kemi pas dërguar në kuvend këtë pikë ju e pate kjekë nga rendi ditës pra është pikë e pa përfunduar e që tani kërkohet miratimi i këtij plani. Ky është një term i ri për institucione e që për këtë plan a pas mbajt një punëtori nga disa sektor.

Alban Krasniqi: Te plani i transparencës i kam komentet e mia te mbledhja e kaluar ueb faqja ka kalu ty cek çka kanë thënë asamblistët e jo qfare vendime janë marrë. Ky plan ka kaluar ndoshta ka zyra e kryesuesit e nëse se kanë pyet aj plan nuk kalon. Në planin e integritetit janë disa hapa a ka nevojë me kanë kaq voluminoz dhe duhet e me ditë sa është kostoja për Komunën. Te dihet çka prek ky plan për mu përmirësuar qeverisja lokale si zbatimi, kontrolli, masat dhe a ka person përgjegjës.

Hashim Vrenezi: S'kam mujt me ditë çka përfiton Komuna a ka me pas ndonjë formular apo diçka rreth këtij plani. Cilat janë masat që merren ndaj një rreziku të tillë.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim për kuvend të kësaj pikë? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i Raportit të Drejtoria e Bujqësisë për mbjelljet pranverore për vitin 2019.

Rrahim Morina: Drejtorit i kam treguar edhe përmes planit të punës e din që ka pas me sjellë raport.

Alban Krasniqi: Nëse ai drejtor përkatës nuk sjell raport cilat janë masat e që s'është hera e parë, sepse ja kemi besuar buxhetin por si pikë te mbetet.

Raimonda Krasniqi: Si drejtori kanë sjellë një dy fletë e këtu është dashtë të jetë raport.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim për kuvend të kësaj pikë? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i Raportit të Punës i DKRS, për periudhën Janar-Maj 2019.

Rrahim Morina: Drejtoresha e Kulturës ka kërkuar që kjo pikë të shtyhet për qershor, pasi që ende se kanë përgatitur raportin e kështu që deri në fund të qershorit ka thënë e përgatisim.

Alban Krasniqi: Disa gjëra është mirë mi debatuar, si vendimi për pagesën 100 euro për fëmijët e porsalindur e për projekte te ndryshme.

6. Debat për hartat zonale.

Alban Krasniqi: Të kërkojmë informacion deri ku ka shkuar procesi i hartimit të hartave zonale, te kërkohej raport nga drejtoria e Urbanizimit për ecurinë e hartave zonale.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim për kuvend të kësaj pikë? Unanimisht ishin për.

7. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.06-58 datë:27.05.2019 e parashtruar nga Arsim Krasniqi nga fshati Terpezë e poshtme për ndërrim destinim të tokës.

Kërkesa nr.06-53 datë:17.05.2019 e parashtruar nga Rexhep Mazeku nga Malisheva për ndërrim destinim të tokës.

Alban Krasniqi: Duhet me vendosë rregull, duhet me ditë vendin ku kërkohej ndërrim destinimi. Le ti referohen Rregullores tash e kemi Rregulloren për ndërrim destinimet.

Rrahim Morina: Unë nga drejtori i Gjeodezisë kam kërkuar që ta kemi një takim me gjete formën si është më mirë lidhur me ndërrim destinimet.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim te këtyre dy kërkesave? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/294 datë:20.05.2019 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Llazicë për dhënien në shfrytëzim të tokës komunale për ndërtimin e Odës së pritjes dhe parkut për lagjen Buzhala.

Alban Krasniqi: Tash atyre kryetarëve të fshatit ju ka skadu mandati, duhet peticion nga ata banoret të asaj lagje që kanë kërkuar, kurse nga Urbanizmi duhet me ditë për gjendjen e pronës dhe a ka kushte aty për ndërtim.

Peticionin nr.02/295 datë:20.05.2019 i parashtruar nga banoret e fshatit Llazicë, kundër marrëveshjes me Hidroregjionin.

Rrahim Morina: Të sillet marrëveshja, peticioni dhe ata banor duhet ta caktojnë një person kontaktues, këtë e kërkojmë me përgjigje.

Kërkesa nr.02/303 datë:22.05.2019 e parashtruar nga Sindikata Komunale e Arsimit parauniversitar SKAP Malishevë.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim për kuvend të kësaj kërkesë? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/242 datë:11.04.2019 e parashtruar nga z.Afrim Morina nga fshati Drenovc Komuna e Malishevës, për ndihmë financiare për ndërtimin e kulmit (pullazit) të shtëpisë.

Alban Krasniqi: Në bazë të rregullores deri 1000 euro kemi të drejtë mi nda, por kërkesat duhet me pas një standard e jo ka raste veç një fletë ne kërkesë e lyp mjete financiare.

Kërkesa nr.02/310 datë: 27.05.2019 e parashtruar nga z. Lulzim Krasniqi nga fshati Astrazup Komuna e Malishevës, për ndërtimin e kulmit të shtëpisë.

Alban Krasniqi: Kjo kërkesë në parim mund të miratohet ama jo në këtë formë, sepse ai kërkesën e ka vetëm me një letër pra është e pa kompletuar.

Hashim Vrenezi: Unë kam kërkuar që për këto kërkesa të kemi një informacion nga drejtoria e financave se a janë ndihmuar ndonjë herë tjetër.

Raimonda Krasniqi: Drejtoria duhet me na informuar për secilin rast kur parashtron kërkesë së a janë ndihmuar ndonjëherë. Ka qenë një rast nga Terpeza në Kpf e kemi ndihmuar dhe ende drejtoria e Financave se ka zbatu vendimin meja nda mjetet.

Kërkesa nr.02/288 datë:14.05.2019 e parashtruar nga Imset Kastrati nga fshati Turjakë.

Unanimisht i përcillet komisionit për shqyrtim te kërkesave për familjet e pa strehë.

Kërkesa nr.02-305 datë:23.05.2019 e parashtruar nga Dalip Halitaj për zyre të shoqatës Shën Tereza.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim për kuvend të kësaj kërkesë? Unanimisht ishin për.

Kërkesa e Muharrem Morines nga fshati Astrazup për ndërtim të shtëpisë.

Unanimisht i përcillet komisionit për shqyrtim te kërkesave për familjet e pa strehë.

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11.10 min.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

